




NDËRMJETËSIMI NË KOSOVË

(Analizë e (mos)zbatimit të ndërmjetësimit në Kosovë)



Autorët: Hajrije Krasniqi, Gzime Hashani dhe Justina Frrokaj

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Mars, 2021

Prishtinë,

Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

PËRMBAJTJA

- 5** PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
- 6** METODOLOGJIA
- 7** NDËRMJETËSIMI NË KOSOVË
- 10** REFERIMI I RASTEVE NË NDËRMJETËSIM
- 14** MOS REFERIMI I RASTEVE NË NDËRMJETËSIM
- 21** FUNKSIONIMI PA BAZË LIGJORE I ODËS SË NDËRMJETËSVE
- 22** MUNGESA E TË DHËNAVE PËR NDËRMJETËSUESIT
- 24** NGRITJA E VETËDIJES SË PUBLIKUT
- 26** RFSSL PËR NDËRMJETËSIMIN
- 28** ANNEX 1: ANALIZË E RASTEVE KARAKTERISTIKE

DP	DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
IKD	INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
MD	MINISTRIA E DREJTËSISË
KPK	KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
KGJK	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
KPPRK	KODI I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KPRK	KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KPPK	KODI PENAL I PËRKOHSHËM I KOSOVËS
GJTH	GJYKATA THEMELORE
PTH	PROKURORIA THEMELORE
LPN	LIGJI PËR NDËRMJETËSIM
GJEDNJ	GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

1. Përmbledhje ekzekutive

Njëra prej mënyra më efikase për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve civile dhe penale, është procedura e ndërmjetësimit, e cila u mundëson palëve që në mënyrë efikase dhe pa formalizma procedural të zgjidhin lëndët e tyre, por se edhe liron sistemin gjyqësor nga një numër i konsiderueshëm i lëndëve.

Përkundër që Kosova ka ndërtuar infrastrukturë të avancuar ligjore sa i përket kësaj fushe, sistemi gjyqësor dhe prokurorial ende nuk e shfrytëzojnë sa duhet këtë mënyrë të zgjidhjes së lëndëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, sistemi i drejtësisë përpos që cenon të drejtat e palëve, gjykatësit dhe prokurorët ngarkojnë veten me lëndë të cilat potencialisht mund të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

IKD ka gjetur se në vitin 2017 dhe 2018 shumë pakë raste janë referuar në ndërmjetësim, derisa ka një ngritje të theksuar në vitin 2019, dhe një regres në vitin 2020.

Krahas mungesës së vetëdijes së qytetarëve mbi mundësitë që ofron ndërmjetësimi, numrit të vogël të rasteve të referuara në ndërmjetësim i kontribuon edhe mos informimi i palëve nga ana e gjyqtarëve për mundësinë që rastet e tyre të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit. Gjatë monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit të drejtësisë, janë evidentuar raste kur përkundër se rastet kanë qenë ligjërish të përshtatshme për ndërmjetësim, gjyqtarët nuk kanë njoftuar palët për këtë, duke vepruar kështu në kundërshtim me rregullat e miratuara nga KGJK.

Në anën tjetër, risi kryesore e Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin është

ndërmjetësimi i detyrueshëm për disa kategori të rasteve civile. Përkundër që ky ligj ka hyrë në fuqi në shtator të vitin 2018, IKD gjenë se gjyqtarët ende nuk janë duke i referuar në ndërmjetësim të detyrueshëm të gjitha lëndët që kërkohet me ligj, duke vepruar kështu në kundërshtim me ligjin.

Në këtë pjesë kërkohet që të jap kontributin e saj edhe Gjykata e Apelit, në mënyrë që duke kthyer në rigjykim dhe rivendosje rastet të cilat nuk janë proceduar në ndërmjetësim të detyrueshëm, të krijojë praktikën gjyqësore në drejtim të zbatimit të këtij obligimi ligjor për të gjitha gjykatat.

Në anën tjetër, nisur nga rëndësia që ka ndërmjetësimi në fushën e sundimit të ligjit, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me institucionet e tjera duhet që të ndërmarrë veprime konkret në drejtim të ngritjes së vetëdijes së publikut që rastet e tyre ti zgjidhin përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Po ashtu, lidhur me ndërmjetësimin Strategjia e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit identifikon po ashtu si problematike mos funksionalitetin e plotë të Odës së Ndërmjetësuesve ku thuhet se *“Odat e këtyre profesioneve të lira, veçanërisht ajo e ndërmjetësuesve, përmbauesve privat dhe administratorëve falimentues, nuk janë ende plotësisht funksionale për të ngritur edhe cilësinë e këtyre profesioneve”*.

Po ashtu, IKD ka gjetur mungesë të të dhënave lidhur me biografinë e ndërmjetësuesve të licencuar, me ç’rast i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që këtë regjistër ta plotësojë edhe me të dhënat lidhur me biografinë profesionale të ndërmjetësuesve të licencuar.

2. Metodologjia

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është organizatë e specializuar në fushën e sundimit të ligjit, e cila monitoron në mënyrë sistematike sistemin e drejtësisë për afërsisht një (1) dekadë. Ky monitorim e IKD-së shtrihet në KGJK, KPK, të gjitha prokuroritë, të gjitha gjykata gjykatat, përfshirë edhe degët e tyre, Ministrinë e Drejtësisë, Komisionin për Legjislacion etj.

IKD ka monitorues në secilën komunë të Republikës së Kosovës, derisa të dhënat e nxjerra gjatë monitorimit të drejtpërdrejt, grumbullohen dhe analizohen në qendrën e IKD-së në Prishtinë.

Kjo metodologji e monitorimit mundëson njohjen për së afër me problemet dhe sfidat e sistemit të drejtësisë.

Rezultat i këtij monitorimi është edhe ky raport. Për draftimin e këtij raporti, para së gjithash, IKD është shërbyer me të dhëna të nxjerra gjatë procesit të monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë.

Po ashtu, IKD për draftimin e këtij raporti ka përdorur edhe dokumente dhe të dhëna të tjera zyrtare të KGJK-së, KPK-së, Gjykatave, Prokurorive dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Me qëllim të një ndërtimi të një raporti sa më gjithëpërfshirës, IKD ka realizuar intervista me të gjithë akterët e përfshirë në fushën e ndërmjetësimit, si dhe para publikimit të këtij raporti, i njëjti i është dërguar për komente të gjithë hisedarëve të kësaj fushe.

Ndërmjetësimi në Kosovë

3. Ndërmjetësimi në Kosovë

Ndërmjetësimi bazohet në pjesëmarrjen vullnetare të palëve si një procedurë në të cilën një ndërmjetësues pa fuqi gjyqësore lehtëson sistematikisht komunikimin midis palëve, me qëllim të aftësimin të vetë palëve që të marrin përgjegjësinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre. Karakteristikat kryesore të ndërmjetësimin janë konfidencialiteti i procedurës dhe neutraliteti i ndërmjetësit. Derisa procedurat gjyqësore janë autoritative dhe formale, ndërmjetësimi ofron një qasje fleksibile, jo formale dhe mbi të gjitha të vullnetshme në të gjitha aspektet¹.

Procedura e ndërmjetësimin ka një sërë benefitesh si për palët, ashtu edhe për sistemin e drejtësisë. Zgjidhja e rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimin u mundëson palëve që me marrëveshje dhe pa procedura të formalizuara të zgjidhin konfliktet e tyre, derisa marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimin është ekuivalente me vendimin gjyqësor. Kjo mënyrë e zgjidhjes së rasteve liron edhe sistemin e drejtësisë nga numri i lëndëve.

Formalizimi i ndërmjetësimin në Kosovë u bë në vitin 2008 përmes miratimit të Ligjit Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësimin, përkundër se ndërmjetësimi si procedurë alternative ishte paraparë edhe me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

Pas miratimit të ligjit, në vitin 2011, nga Ministria e Drejtësisë ishin licencuar ndërmjetësuesit e parë të profileve të

ndryshme, derisa në vitin 2012, ndërmjetësimi filloj të funksionalizohej me hapjen e qendrave të ndërmjetësimin në qendrat rajonale në Kosovë. Ndërmjetësimi në Kosovë, funksionon në kuadër të Departamentit për Profesione të lira në MD. Aktualisht, në Kosovë janë të licencuar rreth 181 ndërmjetësues².

Ligji Nr.03/L-057 për Ndërmjetësimin u shfuqizua më 4 shtator 2018, kur hyri në fuqi Ligji i ri për Ndërmjetësimin, përkatësisht Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin. Ky ligj rregullon mënyrën, funksionimin, procedurën dhe organizimin e ndërmjetësimin, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve me qëllim të lehtësimin të qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe kontesteve si dhe të promovon zgjidhjen miqësore të tyre. Me këtë ligj, kategorizohen edhe natyrat e rasteve gjyqësore të përshtatshme për ndërmjetësim. Për disa natyra të rasteve gjyqësore, ky ligj ka përcaktuar edhe ndërmjetësimin e detyrueshëm³, derisa në këtë ligj nënvizohet se “*Procedura e ndërmjetësimin mund të iniciohet nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ sipas legjislacionit në fuq⁴*”. Ky ligj, krahas përcaktimit të parimeve dhe dispozitave të tjera procedurale, ka përcaktuar edhe rregullat e referimit të rasteve në procedurën e ndërmjetësimin. Ndër të tjera, ky ligj ka përcaktuar edhe detyrimin e gjykatave dhe prokurorive për të caktuar referentin për

¹ Steffek. F. “*Mediation in the European Union: An Introduction*”. Cambridge publication. Qershor 2012. F.1.

² Ministria e Drejtësisë. Ndërmjetësimi. (shih linkun <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,41>). (Qasur për herë të fundit më 27 janar 2021).

³ Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin. Neni 9.

⁴ Po aty. Neni 8.1.

ndërmjetësim. Dispozita që i referohen ndërmjetësimit janë paraparë edhe në Kodin NR. 04/L-123 të Procedurës Penale, sipas të cilit kod, procedura e ndërmjetësimit është njëra prej katër (4) procedurave alternative.

Në anën tjetër, me qëllim të zbatimit të drejtë në praktikë, ky ligj ka përcaktuar edhe obligimin e KGJK-së dhe KPK-së për miratimin e akteve nënligjore⁵.

Në kuptim të përmbushjes së këtij obligimi ligjor, KGJK më 8 maj 2019 ka miratuar Rregulloren nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, derisa KPK më 25 prill 2019 ka miratuar Rregulloren për Procedurën e Ndërmjetësimit të rasteve nga Prokuroria.⁶

Me qëllim të ngritjes së aplikimit të ndërmjetësimit, KGJK me anë të rregullorese së miratuar ka paraparë se secila palë pas parashtrimit të padisë, nga zyra për pranimin e parashtrësive informohet për mundësinë që rastin ta zgjidhë përmes procedurave të ndërmjetësimit.

KGJK me anë të kësaj rregulloreje ka përcaktuar decidivisht se *“Gjyqtari në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kanë mundësi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit”*. Po ashtu, KGJK në janar të vitit 2020 ka miratuar *“Udhëzuesin për lëndët e gjykatave të*

përshtatshme për Ndërmjetësim”, ku ka listuar kategorinë e lëndëve të përshtatshme për ndërmjetësim.⁷

Në anën tjetër, edhe KPK ka përcaktuar obligimin e Prokurorit të Shtetit për tu angazhuar në zbatimin e procedurës së ndërmjetësimit. Në këtë drejtim, Rregullorja e KPK-së ka përcaktuar shprehimisht se *“Pasi që prokurori i shtetit vlerëson përshtatshmërinë e rastit merr vendim për referimin e atij rasti në procedurën e ndërmjetësimit. Edhe palët mund t'i propozojnë prokurorit, me parashtrësë ose gojarisht, që rasti i tyre të referohet në procedurën e ndërmjetësimit. Nëse prokurori vlerëson se rasti është i përshtatshëm, atëherë merr vendim për referim në ndërmjetësim”*.

⁵ Po aty. Neni 8, paragrafi 4 dhe 5.

⁶Shih Shala G. *“Këshilla për Këshillat”*. IKD. Prill. 2020. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/Keshilla-per-Keshillat-IKD-12.04.2020-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2021).

⁷ Udhëzues për lëndët e gjykatave të përshtatshme për Ndërmjetësim. (Shih linkun https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/2548_Udhezues_per_lendet_gjykatave_te_pershtatshme_per_ndermjetesim.pdf) (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2021).

Referimi i rasteve në ndërmjetësim

4. Referimi i rasteve në ndërmjetësim nga gjykatat


Përkundër dobive të mëdha të palëve dhe sistemit gjyqësor nga procedura e ndërmjetësimit, referimi i rasteve në procedurë të ndërmjetësimit nga ana e sistemit gjyqësor është në margjina të ulëta.

Sipas të dhënave statistikore të gjykatave, nga i gjithë sistemi gjyqësor, në vitin 2017 në procedurë të ndërmjetësimit ishin referuar gjithsej 508 raste, derisa ky numër ishte ngritur në vitin 2018, ku në procedurë të ndërmjetësimit ishin referuar gjithsej 910 raste. Ngritje e theksuar e referimit të rasteve në procedurë të ndërmjetësimit ishte shënuar në vitin 2019, ku gjykatat në këtë procedurë kishin referuar gjithsej 2,851 raste, derisa në vitin 2020, gjatë të cilit vit edhe puna e sistemit gjyqësor është influencuar nga gjendja e krijuar nga pandemia COVID-19, ky numër ka rënë në 1,507.

Gjatë vitit 2017 GjTh në Prishtinë prin me numrin më të madh të lëndëve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit, me 230 raste, pasuar nga ajo e Gjilanit me 158 raste. Ndërkaq shifra të ulëta të referimit të rasteve në procedurë të ndërmjetësimit janë në gjykatat e tjera. Gjatë vitit 2018 GjTh në Prishtinë sërish prin me 393 raste të referuara në ndërmjetësim, pastaj Ferizaj me 219 dhe Prizreni me 187. Derisa në gjykatat tjera ka shifra të ulëta të rasteve të referuara në ndërmjetësim.

Gjatë vitit 2019, GjTh në Prishtinë ka referuar në procedurë të ndërmjetësimit 849 raste, ajo në Prizren 689 raste, në Ferizaj 483 raste, në Gjilan 424 raste, Mitrovicë 223 raste, Pejë 103 rast dhe Gjakovë 80 raste.

Gjatë vitit 2020 ka një rënie të rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit. Gjykata e cila ka më së shumti raste të referuara në ndërmjetësim mbetet ajo në Prishtinë, me 413 raste, pastaj ajo në Prizren me 333 raste, në Ferizaj me 271 raste, në Gjilan 190 raste, pastaj Gjakovë 130 dhe Mitrovicë 119.



Grafika 1. Rastet e referuara në procedurë të ndërmjetësimit për periudhën 2017 – 2020, në Gjykatat Themelore.

4.2 Referimi i rasteve në procedurën e ndërmjetësimit nga Prokuroritë

Referimi i rasteve në procedurë të ndërmjetësimit ulë ngarkesën me lëndë edhe të sistemit prokurorial. Mirëpo përkundër mundësive ligjore që prokuroritë të ulin ngarkesën me lëndë dhe një numër të madh të lëndëve ta zgjidhin përmes kësaj procedure, statistikat tregojnë për një referim të pamjaftueshëm të rasteve të Prokurorit të Shtetit në procedurë të ndërmjetësimit.

Sipas statistikave zyrtare, gjatë vitit 2017, të gjitha prokuroritë e Kosovës kanë referuar në ndërmjetësim gjithsej 682 raste, derisa në vitin 2018 ky numër është ngritur


në 904. Ky numër ishte rritur dukshëm në vitin 2019, kur prokuroritë kishin referuar në ndërmjetësim gjithsej 2,034 lëndë. Gjatë vitit 2020, kur edhe puna e Prokurorit të Shtetit është influencuar nga gjendja e krijuar me pandeminë COVID-19, Prokurori i Shtetit ka referuar në ndërmjetësim gjithsej 1,608 lëndë.

Sipas prokurorive, gjatë vitit 2017, PTh e cila më së shumti ka referuar lëndë në procedurë të ndërmjetësimit është ajo në Prizren me 230 raste, pastaj ajo në Ferizaj me 158 raste, Gjakovë 79, Pejë 65 raste, Mitrovicë 61 dhe Gjilani 51.

Gjatë vitit 2018, Prizreni mbetet Prokuroria me më së shumti raste të referuara në ndërmjetësim me gjithsej 360 raste, pastaj Peja me 195, Prishtina me 156, Ferizaj 93, Gjilani 73, Gjakova 27 dhe Mitrovica asnjë rast.

Gjatë vitit 2019, PTh e cila ka referuar më së shumti raste në procedurë të ndërmjetësimit është ajo në Pejë me 745 raste, pastaj ajo në Prizren me 365 raste, Prishtinë 293 raste, 21 raste PTh në Mitrovicë, 171 në Ferizaj, 154 në Gjakovë dhe 94 në Gjilan.

Gjatë vitit 2020 PTh në Prishtinë ka referuar 494 raste në procedurë të ndërmjetësimit pasuar nga ajo në Pejë me 456 raste, 270 nga ajo në Gjakovë, 139 raste janë referuar nga PTh në Prizren, 125 raste në Ferizaj, 41 në Gjilan dhe 83 në Mitrovicë.



Grafika 2: Rastet e referuara në procedurë të ndërmjetësimit për periudhën 2017 – 2019, në Prokuroritë Themelore.⁸

Në përgjigjen elektronike të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, dhënë IKD-së lidhur me procedurën e referimit të rasteve për ndërmjetësim, e njëjta është përgjigjur shkurt se, “*Ju njoftojmë se zgjidhja e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.*”⁹

Në përgjigjen e Prokurorisë Themelore në Ferizaj thuhet se kjo prokurori aplikon procedurën e ndërmjetësimit, dhe prokurorët e kësaj prokurorie gjithherë në bazë të dispozitave ligjore i njoftojnë palët lidhur me procedurën e njëjtë.¹⁰

Në përgjigjen e tij, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj ka thënë se prokurorët e kësaj prokurorie kanë

⁸ Përgjigje në kërkesat për statistika të dhënë për IKD.

⁹ Zyrtarja për Informim dhe Monitorim të Mediave në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Laureta Ulaj. Përgjigje elektronike për IKD. 26.05.2020.

¹⁰ Zyrtarja për Informim dhe Monitorim të Mediave në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, Vjosa Baftiu. Përgjigje elektronike për IKD. 21.05.2020.

vepruar konform rregullores. “Prokuroria Themelore në Ferizaj, të gjitha rastet të cilat janë të përshtatshme për ndërmjetësim i ka referuar për ndërmjetësim, mirëpo ka pasur raste edhe kur lënda është referuar për ndërmjetësim por palët nuk kanë dhënë propozimin për ndërmjetësim. Të gjithë prokurorët në PTH – Ferizaj, deri më tani me përpikëri kanë respektuar rregulloren e KPK-së sa i përket rasteve të cilat mund të kryhen në procedurë të ndërmjetësimit” ka thënë Kryeprokurori Shukri Jashari.¹¹

Në përgjigjen e tij të dhënë me shkrim në pyetjet e IKD, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ka thënë se të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie i referojnë lëndët në procedurë të ndërmjetësimit.¹²

Një gjë e tillë është thënë edhe nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan i cili përmes përgjigjes ka thënë se prokurorët e kësaj prokurorie i referojnë gjithmonë rastet në procedurë të ndërmjetësimit.¹³

Lidhur me mos referimin e lëndëve të përshtatshme për ndërmjetësim në procedurë të ndërmjetësimit IKD ka dërguar pyetje edhe tek kryeprokurorët e tjerë, por se nuk ka marrë përgjigje.

Rekomandim:

1. KGJK, KPK, Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët të marrin veprime konkrete në drejtim të ngritjes së zbatimit të ndërmjetësimit në Kosovë.
2. KGJK, KPK, Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët të masin vazhdimisht trendin e referimit të rasteve në procedurë të ndërmjetësimit, dhe raportet e kësaj natyre ti publikojnë në faqet zyrtare.

¹¹ Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 23.02.2021

¹² Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 25.02.2021

¹³ Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 25.02.2021

**Mos referimi i rasteve në
ndërmjetësim**

5. Mos referimi nga gjykatat i rasteve të përshtatshme për referim

Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe aktet nënligjore të KGJK-së dhe KPK-së kanë synuar ngritjen e zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit. Zbatimi i kësaj procedure alternative është jashtëzakonisht i rëndësishëm, si për palët ashtu edhe për sistemin e drejtësisë, veçanërisht nisur nga fakti se intencë pothuajse kryesore e sistemit kosovar të drejtësisë tash e disa vite është ulja e numrit të lëndëve të pazgjidhura.

Në këtë drejtim, edhe rregullorja e KGJK-së ka përcaktuar se në secilin rast të përshtatshëm për ndërmjetësim, gjyqtari obligohet që të referojë rastet në procedurë të ndërmjetësimit. Lidhur me këtë, KGJK me anë Rregullores ka përcaktuar decidivisht se *“Gjyqtari në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kanë mundësi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit”*.

Për më tepër, KGJK në janar të vitit 2020 ka miratuar *“Udhëzuesin për lëndët e gjykatave të përshtatshme për Ndërmjetësim”*, ku ka listuar veprat penale të përshtatshme për ndërmjetësim.¹⁴

Por, përkundër obligueshërisë së gjyqtarëve që secilin rast ta referojnë në ndërmjetësim, IKD gjatë monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor ka gjetur se kjo dispozitë nuk zbatohet në secilin rast.

Kjo pasi gjatë monitorimit, IKD ka gjetur raste konkrete, të përshtatshme për

ndërmjetësim, në të cilat gjyqtarët nuk kanë informuar palët se rasti i tyre mund të referohet në ndërmjetësim. Përkatesisht, gjyqtarët nuk u kanë mundësuar palëve që të shprehin vullnetin e tyre që rastin e përshtatshëm për ndërmjetësim ta zgjidhin përmes kësaj procedure.

Në këtë drejtim, IKD gjatë monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë ka evidentuar të paktën 11 raste penale në të cilat gjyqtarët nuk kanë referuar rastet në ndërmjetësim, përkatesisht nuk kanë informuar palët për mundësinë që rasti i tyre të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit.

Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtarët fillimisht e kanë ngarkuar veten e tyre me lëndë, të cilat me vullnetin e palëve kanë mundur ti referojnë në procedurë të ndërmjetësimit. Për të ekzistuar një vullnet i tillë, para së gjithash kërkohet informim nga ana e gjyqtarëve, përkatesisht respektim të nenit të Rregullores.

Mos referimi i rasteve të përshtatshme në ndërmjetësim është po ashtu ngarkesë për gjykatën dhe gjyqtarin përkatës, për arsye se lëndët të cilat potencialisht mund të zgjidhen përmes procedurës së ndërmjetësimit, duhet të zgjidhen nga ana e gjykatës.

Mos referimi i rasteve të kësaj natyre në procedurë të ndërmjetësimit dëmton edhe interesat e palëve, si palës së dëmtuar ashtu edhe të të pandehurit.

Zgjidhja e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit i mundëson palës së dëmtuar që pa formalizma të tepruar dhe

¹⁴ Udhëzues për lëndët e gjykatave të përshtatshme për Ndërmjetësim. (Shih linkun [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/2548_Udhezues_per_lendet_gjykatave_te_pershtatshme_per_ndermjetesim.pdf)

[content/uploads/lgs/2548_Udhezues_per_lendet_gjykatave_te_pershtatshme_per_ndermjetesim.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/2548_Udhezues_per_lendet_gjykatave_te_pershtatshme_per_ndermjetesim.pdf)) (Qasur për herë të fundit më 14 janar 2021).

brenda periudhës kohore shumë më të shkurtër të realizojë dëmshpërblimin.

Sa i përket të pandehurit, procedura e ndërmjetësimit në këto raste do të mundësonte të njëjtit që rastet e tyre të përfundonin brenda një afati më të shpejtë kohor dhe po ashtu rasti i tyre nuk do të kishte pasoja juridike, përkatësisht i pandehuri nuk do të bëhej pjesë e evidencave penale.

Për më tepër, mos referimi i rasteve në procedurë të ndërmjetësimit është në linjë të kundërt me synimet që ka pasur infrastruktura e re ligjore përkitazi me sistemin e ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës.

Por, mbi të gjitha, mos referimi i këtyre rasteve në procedurë të ndërmjetësimit paraqet shkelje të Rregullores së KGJK-së, e cila është derivat i Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin.

Mos respektimi në praktikë i rregulloreve të KGJK-së nga gjykatat, në rastin konkret Rregullores, paraqet një politikë të mirë në letër, por pa efekt në ngritjen e administrimit të mirë të drejtësisë.

Për këtë arsye, me qëllim të avancimit të aplikimit të procedurës së ndërmjetësimit, rrjedhimisht uljes së numrit të lëndëve në gjykata, KGJK duhet që përmes mekanizmave të saj të brendshëm të monitorojë zbatimin në praktikë të kësaj rregulloreje, dhe të mbajë përgjegjës gjyqtarët të cilët në kundërshtim me Rregulloren Nr.04/2019 nuk referojnë rastet në procedurën e ndërmjetësimit.

Për më tepër, KGJK dhe gjyqtarët duhet të angazhohen që informimi i palëve lidhur me mundësinë e zgjidhjes së rasteve në

procedurë të ndërmjetësimit të jetë i qartë dhe gjithëpërfshirës, në mënyrë që palët praktikisht të kuptojnë dobitë që kanë nëse rastin e tyre e zgjidhin në procedurë të ndërmjetësimit.

Rekomandime:

1. Gjyqtarët dhe prokurorët të referojnë në ndërmjetësim secilin rast të përshtatshëm për ndërmjetësim.
2. KGJK dhe KPK të monitorojnë referimin e rasteve në procedurë të ndërmjetësimit dhe përmes mekanizmave të saj të mbajë përgjegjës gjyqtarët dhe prokurorët të cilët nuk referojnë në ndërmjetësim rastet e përshtatshme për ndërmjetësim.

Lidhur me këtë IKD ka kërkuar nga Kryetarët e gjykatave komente lidhur me mos përmbushjen e obligimeve ligjore për referimin e lëndëve në procedurë të ndërmjetësimit dhe nëse janë inicuar procedura disiplinore.

Mirëpo përgjigje është dhënë vetëm nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren dhe asaj në Gjilan.

Sipas Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, *“kjo gjykatë respekton rregulloren e KGJK-së duke i referuar të gjitha lëndët e përshtatshme për ndërmjetësim në procedurë të ndërmjetësimit. “Nuk ka asnjë rast që gjyqtari nuk i informon palët për këtë procedurë, kuptohet, tek rastet kur i*

parasheh ligji” ka thënë Kryetari i kësaj gjykate, Artan Serjani.¹⁵

Përgjigje të njëjtë ka dhënë edhe Kryetari Gjykatës Themelore në Gjiilan duke thënë se të gjitha rastet e përshtatshme për ndërmjetësim referohen në procedurë të ndërmjetësimit.¹⁶

Ndërkaq në KGJK thonë se gjykatësit kanë në diskrecion të vlerësojnë përshtatshmërinë e lëndëve për ndërmjetësim.¹⁷

5.1. Mos aplikimi i ndërmjetësimit të detyrueshëm

Njëra ndër risitë kryesore të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin është fusha e ndërmjetësimit të detyrueshëm. Ky lloj i ndërmjetësimit është inkorporuar në ligjin e ri me qëllim të ngritjes së aplikimit të procedurës së ndërmjetësimit dhe rrjedhimisht, shkarkimin sa më të madh të gjykatave me lëndë.

Në këtë drejtim, neni 9.1. i Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin përcakton se *“Kur palët parashtrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për kontestet nga marrëdhëniet familjare lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarjen e pronës së përbashkët martesore, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të informojë dhe obligojë palët në procedurën e ndërmjetësimit”*.

Ndërsa, neni 9.2. i këtij ligjit përcakton se *“Kur palët parashtrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve, dhe kompensimi i pronës së shpronësuar, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të kërkesëpadisë, detyrohet të informojë dhe udhëzojë palët në procedurën e ndërmjetësimit”*.

Por, përkundër faktit se për ndërmjetësimin e detyrueshëm ekziston një dispozitë e qartë e cila obligon gjyqtarët që këto raste ti procedojnë në procedurë të ndërmjetësimit, IKD gjenë se kjo fushë e ndërmjetësimit në Kosovë nuk ka gjetur zbatimin e kërkuar.

Fillimisht, numri i rasteve të cilat janë procedura në ndërmjetësim të detyrueshëm është shumë i vogël. Në këtë drejtim, bazuar në të dhënat statistikore mbi numrin e rasteve të referuara në ndërmjetësim të detyrueshëm, GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2020 ka referuar në ndërmjetësim të detyrueshëm gjithsej 52 lëndë, ajo në Ferizaj 21, ajo në Pejë 17, ajo në Prizren 13 dhe në Gjakovë nëntë (9). Ndërsa, Gjykata Themelore në Mitrovicë gjatë gjithë vitit 2020, në ndërmjetësim të detyrueshëm ka referuar vetëm katër (4) lëndë, ndërsa ajo në Gjiilan vetëm dy (2).

¹⁵ Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 22.02.2021

¹⁶ Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 22.02.2021

¹⁷ Përgjigje në kërkesën për intervistë me shkrim të IKD përmes emailit më datë 24.02.2021

Gjykata Themelore	Numri i rasteve të ndërmjetësimit të detyrueshëm
Prishtinë	52
Ferizaj	21
Pejë	17
Prizren	13
Gjakovë	9
Mitrovicë	4
Gjilan	2

Tabela 1: Numri i rasteve të referuara nga gjykatat në ndërmjetësim të detyrueshëm gjatë vitit 2020.

Pra, nga të këto të dhëna, IKD gjenë se ndërmjetësimi i detyrueshëm nuk ka arritur të gjejë zbatim në praktikë ashtu siç kërkohet me ligj, pasi numri i rasteve të referuara në ndërmjetësim të detyrueshëm është shumë i ulët.

Në këtë drejtim, sistemi gjyqësor nuk gjeneron statistika të detajuara lidhur me këtë pjesë, në mënyrë që të jetë e matshme se në sa raste nuk është aplikuar ndërmjetësimi i detyrueshëm, e që është dashur të aplikohet. Për më tepër, shumica e gjykatave ende nuk i kanë gjeneruar as statistikat e përgjithshme mbi natyrën e lëndëve për vitin 2020.

Por se, nëse i referohemi disa statistikave të përgjithshme, që në statistikat e gjykatave evidentohen si raste të 1) alimentacionit, 2) të tjera konteste nga marrëdhëniet martesore dhe familjare, 3) lëndë të ndryshme civile (nga kategoria e kontesteve të marrëdhënieve martesore dhe familjare dhe 4) të tjera konteste familjare,

atëherë shohim një disbalanc të madh me numrin e lëndëve të referuara në ndërmjetësim të detyrueshëm, përkundër se ky raport numerik nuk mund të konsiderohet preciz.

Në këtë kuptim, Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2019 ka qenë e ngarkuar me gjithsej 811 raste të kësaj natyre, ndërsa në vitin 2020 në ndërmjetësim të detyrueshëm janë proceduar vetëm 52 raste

Gjykata Themelore në Gjakovë në vitin 2020 ka qenë e ngarkuar me 111 raste të kësaj natyre, derisa ka proceduar në ndërmjetësim të detyrueshëm vetëm 9 raste.

Gjykata Themelore në Mitrovicë gjatë vitit 2020 ka qenë e ngarkuar me 23 raste të kësaj natyre, derisa në ndërmjetësim të detyrueshëm ka referuar vetëm 4 raste.

Ndërsa, Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2020 ka qenë e ngarkuar me 56 raste të kësaj natyre, derisa ka referuar në ndërmjetësim të detyrueshëm 21 raste.

Andaj, mbi bazën e këtyre të dhënave, IKD gjenë se ndërmjetësimi i detyrueshëm i përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin, nuk ka gjetur zbatim në praktikë.

Këtij mos zbatimi në praktikë të ndërmjetësimit të detyrueshëm duhet ti përgjigjet edhe Gjykata e Apelit, duke kthyer në pikën zero raste të cilat nuk janë referuar në ndërmjetësim, e që ky referim ka qenë obligativ sipas ligjit.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton se “*Aktgjykimi mund të goditet: a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore*”, derisa neni 182.1. i këtij ligji përcakton se

“Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë”.

Neni 9.1. i Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin përcakton se *“Kur palët parashetrojnë kërkesëpadi në gjykatë, për kontestet nga marrëdhëniet familjare lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet, mbajtja e fëmijës dhe ndarjen e pronës së përbashkët martesore, gjyqtari në seancën përgatitore dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të informojë dhe obligojë palët në procedurën e ndërmjetësimi”.*

Në këtë mënyrë, kjo dispozitë e Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin, për rastet e këtyre natyrave, është bërë pjesë integrale e procedurës kontestimore.

Për këtë arsye, me qëllim të zbatimit të ligjit dhe uniformimit të praktikës në këto raste, Gjykata e Apelit duhet të kthejë në pikën 0 të gjitha rastet në të cilat aplikohet ndërmjetësimi i detyrueshëm, e të cilat nuk janë referuar në ndërmjetësim.

Rekomandime:

1. Gjyqtarët ti referojnë në ndërmjetësim të detyrueshëm të gjitha rastet që kërkohet me ligj.
2. Kryetarët e Gjykatave në bashkëpunim me gjyqtarët të përpilojnë listat me të gjitha rastet ku kërkohet ndërmjetësim i detyrueshëm, dhe të njëjtat të procedohen në ndërmjetësim.
3. KGJK në bashkëpunim me Kryetarët e Gjykatave të informojë dhe kërkojë nga gjyqtarët që në secilin rast kur kërkohet me ligj, të aplikojnë ndërmjetësimin e detyrueshëm.
4. Avokatët të kërkojnë nga gjykatat referimin në ndërmjetësim të detyrueshëm, në rastet kur kjo kërkohet me ligj.
5. Avokatët me rastin e parashtrimit të ankesave në Gjykatën e Apelit, të arsyetojnë shkeljet me rastin e mos referimit të rasteve në ndërmjetësim të detyrueshëm, kur kjo është kërkuar me ligj.
6. Gjykata e Apelit të kthejë në pikën 0, në rigjykim dhe rivendosje secilin rast i cili nuk është referuar në ndërmjetësim, e që referimi në këtë procedurë ka qenë i obliguar sipas ligjit.

Funksionimi pa bazë ligjore i Odës së Ndërmjetësuesve

6. Funksionimi pa bazë ligjore i Odës së Ndërmjetësve

Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim në nenin 21.1. ka përcaktuar se *“Oda e Ndërmjetësuesve është person juridik i pavarur jofitimprurës, që vepron në pajtim me këtë ligj dhe statutin e saj të miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve dhe të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë”*.

Përkitazi me këtë dispozitë ligjore, Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve ka miratuar statutin më 2 nëntor 2019.

Por, dispozita e nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim krahas miratimit të statutit nga ana e Kuvendit të Përgjithshëm, kërkon edhe aprovimin nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Statuti i miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve në këtë rast nuk është aprovuar nga Ministria e Drejtësisë deri më 21 shtator 2020.

Duke vepruar në këtë mënyrë, IKD ka gjetur se Oda e Ndërmjetësuesve e cila vepron në pajtim me ligjin dhe statutin e saj, në këtë rast ka vepruar pa bazë ligjore, pasi statuti i saj, nuk ka qenë i aprovuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, rrjedhimisht nuk ka qenë në fuqi.

Mirëpo ndërmarrjen e veprimeve pa bazë ligjore e ka arsyetuar Kryetari i Odës së Ndërmjetësuesve, Faton Morina përmes përgjigjeve që i ka dhënë për IKD përmes postës elektronike.¹⁸

Sipas tij këto vonesa janë bërë për shkaqe politike, pasi që gjatë kësaj periudhe disa herë është ndërruar Ministri i Drejtësisë,

¹⁸ Përgjigja e Kryetarit të Odës së Ndërmjetësuesve për IKD-në. 11 mars 2021.

dhe në këto vonesa ka kontribuar edhe gjendja e krijuar me Covid-19. Kryetari i Odës përmes përgjigjeve të dhëna për IKD thotë se udhëheqësia e Odës, e shtyrë nga vullneti i mbarëvajtjes së procesit të ndërmjetësimit, kryesisht ka qenë e fokusuar në promovim dhe koordinim e disa aktiviteteve të domosdoshme në procesin e ndërmjetësimit në vend.

Ndër veprimet që Oda ka ndërmarr sipas kryetarit të saj takimet me hisedarët institucional të Ndërmjetësimit (MD, KGJK, KPK, Gjykata, Prokurori etj), hapja e zyrave të Odës, në të cilat tani përveç aktiviteteve të Odës mund të mbahen edhe seanca të ndërmjetësimit nga ana e ndërmjetësuesve për rastet me vete referim.

Ai shton se gjatë kësaj kohe kanë vepruar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe USAID-in.

Ndërkaq përmes postës elektronike për IKD-në Ministria e Drejtësisë ka deklaruar se kjo ka ndodhur për shkak të rrethanave politike të krijuara në vend. Sipas MD-së, ka qenë e pamundur që Statuti të aprovohet menjëherë pas miratimit të tij nga Kuvendi i Përgjithshëm i Odës së Ndërmjetësuesve.¹⁹

¹⁹ Përgjigja e MD-së për IKD-në. 12 mars 2021.

Mungesa e të dhënave për ndërmjetësesit

7. Mungesa e të dhënave mbi profilin e ndërmjetësuesve të licencuar

Në bazë të regjistrit të ndërmjetësuesve, të publikuar në faqen elektronike të Ministrisë së Drejtësisë, figurojnë 181 ndërmjetësues të licencuar.

Por, në këtë regjistër figurojnë vetëm emri, mbiemri, dhe numrit i telefonit, derisa nuk ofrohen të dhëna të tjera lidhur me aspektin profesional të këtyre ndërmjetësuesve.

Në këtë drejtim, përpos që vetë inicimi i procedurës së ndërmjetësimit varet nga vullneti i palëve, palët po ashtu disponojnë me të drejtën për të zgjedhur ndërmjetësuesin në rastin e tyre.

Në këtë drejtim, me qëllim të ngritjes së besimit të palëve në profesionalizmin dhe integritetin e vetë procedurës së ndërmjetësimit, e rëndësishme është që palët, para së gjithash, të kenë njohuri për ndërmjetësuesit. Në fakt, njohuria e palëve për ndërmjetësuesit e bënë më të besueshëm procedurën e ndërmjetësimit qysh para fillimit të kësaj procedure.

Për këtë arsye, palët duhet të kenë mundësi që të kenë qasje në biografinë profesionale të ndërmjetësve.

Në këtë drejtim, IKD konsideron se regjistri i ndërmjetësuesve i publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë duhet të publikohet edhe me të dhëna të tjera në mënyrë që palët të kenë njohuri mbi ndërmjetësuesit e licencuar me rastin e përzgjedhjes së ndërmjetësuesit për rastin e tyre.

Rekomandim:

1. Departamenti për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë të plotësojë listën e ndërmjetësuesve me të dhënat mbi biografinë profesionale të secilit ndërmjetësues.

Ngritja e vetëdijes së publikut

8. Ngritja e vetëdijes së publikut mbi benefitet e ndërmjetësimit

Siç tanimë është thënë në këtë raport, zgjidhja e rasteve gjyqësore, penale, civile dhe administrative përmes procedurës së ndërmjetësimit ka favore shumëdimensionale, si për sistemin gjyqësor dhe prokurorial, po ashtu edhe për palët.

Krahas ndërtimit të mekanizmave institucional për zhvillimin e ndërmjetësimit dhe detyrueshmërisë së prokurorëve dhe gjyqtarëve që rastet e përshtatshme për ndërmjetësim ti referojnë në këtë procedurë, mbi të gjitha, e rëndësishme është që të ngritet edhe vetëdija e qytetarëve mbi mundësinë dhe benefitet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Në këtë drejtim, e rëndësishme është që për ngritjen e vetëdijes të angazhohen të gjithë hisedarët e zbatimit të ligjit në Kosovë, në mënyrë që të përqohet informacioni dhe mesazhi tek publiku mbi benefitet e tyre me rastin e aplikimit të procedurës së ndërmjetësimit.

Ngritja e vetëdijes mbi procedurën e ndërmjetësimit dhe procedurat e tjera alternative të zgjidhjes së kontesteve është po ashtu gjetje e dokumenteve të Procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit.

Në dokumentin e këtij procesi që flet për profesionet e lira thuhet se: *“Posaçërisht, ndërmjetësimi dhe dobitë e tij potenciale janë pothuajse të panjohura për qytetarët.*

Të gjitha standardet evropiane dhe praktikat më të mira në dispozicion, më të rëndësishmet e të cilave janë referuar më sipër në këtë dokument, bëjnë thirrje për rolin aktiv të hisedarëve të ndërmjetësimit, p.sh. gjykatësve, prokurorëve, avokatëve, qeverive, etj., në promovimin e ndërmjetësimit dhe mekanizmave të tjerë alternativ për zgjidhjen e kontesteve. Kjo mund të përfshijë shkrim/informacione në media, shpërndarjen e informacionit përmes fletëpalosjeve/broshurave, linjës telefonike për ndërmjetësim, javëve të ndërmjetësimit etj. Më tej, rekomandimet u bëjnë thirrje Shteteve dhe hisedarëve të ndërmjetësimit që të vënë në dispozicion informacione për publikun se si të kontaktojnë me ndërmjetësuesit dhe organizatat që ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit, si dhe të përfshijnë ndërmjetësimin dhe format e tjera për zgjidhjen e kontesteve në kurrikulën kombëtare të shkollave”²⁰.

Rekomandim:

1. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me të gjithë hisedarët e zbatimit të ligjit, të hartojë dhe implementojë një plan për ngritjen e informimit dhe vetëdijes së publikut mbi benefitet që sjellë zgjidhja e kontesteve përmes procedurës së ndërmjetësimit.

²⁰ Dokumenti i politikave profesionet e lira te rishikimit funksional.

RFSSL për ndërmjetësimin

9. Gjetjet dhe rekomandimet e RFSSL për ndërmjetësimin

Ministria e Drejtësisë që nga fillimi i vitit 2018 ka filluar zhvillimin e procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL).

RFSSL ishte dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë analizë të thuktë dhe të detajuar të problemeve në fushën e sundimit të ligjit. Aktualisht, ky proces është në fazën e draftimit të strategjisë. Hartimit të strategjisë i kanë paraprirë dy faza të tjera zhvillimore në kuadër të RFSSL-së.

Në Draft Strategjinë për Sundim të Ligjit, ndër të tjera, thuhet se “Pavarësisht rregullativës ligjore, kryesisht të mirëfilltë për arbitrazhin dhe sidomos për ndërmjetësimin, palët rrallë herë i përdorin ato. Palët janë pak të informuara për mundësitë që ato i krijojnë për zgjedhje efikase të kontesteve”²¹.

Strategjia e RFSSL identifikon po ashtu si problematike mos funksionalitetin e plotë të Odës së Ndërmjetësuesve: “Odat e këtyre profesioneve të lira, veçanërisht ajo e ndërmjetësuesve, përmbauesve privat dhe administratorëve falimentues, nuk janë ende plotësisht funksionale për të ngritur edhe cilësinë e këtyre profesioneve”²²” thuhet në strategjinë e RFSSL.

Sipas kësaj strategjie, Ndërmjetësimi, ndër të tjera, do të ndikojë dukshëm në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura. Në këtë drejtim, Strategjia e RFSSL nënvizon se “Stimulimi i përdorimit të mekanizmave alternative për zgjidhje të mosmarrëveshjeve (ZAK), siç janë

arbitrazhi (për çështjet civile) dhe ndërmjetësimi (çështje civile dhe penale) do të ndikojë dukshëm në uljen e numrit të lëndëve të nevojshme të zgjidhen nga gjykatat. Në kuadër të kësaj, propozohen investimet në kompletimin e kornizës sekondare ligjore dhe infrastrukturore për të mundësuar referimin e rasteve në ndërmjetësim, si dhe nxitja e përdorimit të arbitrazhit nga bizneset”.

Në anën tjetër, dokumenti mbi profesionet e lira i dalë nga procesi i RFSSL propozonte gjithsej pesë (5) intervenime në lidhje me ndërmjetësimin: 1) Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të dala nga Ligji i ri për Ndërmjetësim, 2) Ofrimi masave të nevojshme (përfshirë për nevojat infrastrukturore) të Odës së Ndërmjetësuesve që të bëhet plotësisht funksionale, 3) Sigurimi që mekanizmat ekzistues apo të ri të komunikimit në mes të institucioneve të caktuara shtetërore dhe strukturave të ndërmjetësimit janë gjithëpërfshirëse dhe efikase, 4) Ofrimi i zyrave të ndërmjetësimit në gjykata dhe prokurori me burime financiare, infrastrukturore dhe njerëzore shtesë, 5) Realizimi i një fushatë të qëndrueshme të vetëdijesimit publik për rolin e ndërmjetësimit (dhe mbi mekanizmat e tanishëm të ndërmjetësimit dhe përfitimet që ato sjellin), si në mesin e profesionistëve ashtu dhe publikun e gjerë.

²¹ “Projekt-Strategjia për Sundimin e Ligjit”. Ministria e Drejtësisë. F. 9. (Shih linkun <https://konsultimet.rks->

gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41053).

(Qasur për herë të fundit më 8 mars 2021).

²² Po aty. Faqe 17.

Annex 1: Analizë e rasteve karakteristike

10. Annex I: Analizë e rasteve karakteristike kur rastet e përshtatshme nuk janë proceduar në ndërmjetësim

Në vijim të këtij raporti, IKD ka paraqitur disa prej rasteve të monitoruara, kur lëndët kanë plotësuar kushtet për tu referuar në ndërmjetësim por që nuk janë referuar. Përkatësisht, në këto raste të monitoruara, IKD ka gjetur se gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore, palët nuk janë njoftuar mbi mundësinë që rasti i tyre të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit.

Në këtë drejtim, IKD ka analizuar në detaje rastet në vijim, ku ka paraqitur të dhënat e rastit si dhe ka treguar për rrjedhën procedurale të këtyre rasteve.

Po ashtu, IKD ka paraqitur edhe gjetjet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit të këtyre rasteve.

Rasti Nr. 1

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.3183/16

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve komunale”

Gjykatësi: Adnan Isufi

Prokuror: Merita Shala Muhaxhiri

I pandehur: Agron Kurtiqi

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së ngritur më 21 korrik 2016, Agron Kurtiqi akuzohet se prej datës së pavërtetuar e deri më 23 nëntor 2015, në shtëpinë e tij, në fshatin Bresje, në lagjen 29, Komuna Fushë Kosovë, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, është kyçur në rrjet - jashtë njehsorit elektrik, duke mundësuar shpenzimin e energjisë elektrike

pa matje, me ç ‘rast i ka shkaktuar dëm KEDS-it, në vlerë prej 107.30 euro.

Me këto veprime, prokuroria e ngarkon të akuzuarin Agron Kurtiqi se ka kryer veprën penale “Vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 të KPK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Prishtinë më 23 prill 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Kurtiqi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej tetë muaj burgim me kusht, kjo pasi që Kurtiqi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Kurtiqi, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Lidhur me këtë Ligji Nr.06/L-009 për Ndërmjetësimin ka paraparë që “*Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nxjerr akt nënligjor me të cilin përcaktohet procedura e referimit të rasteve nga gjykata sipas paragrafit 1. të këtij neni.*”

Përkitazi më këtë KGJK ka miratuar rregulloren për procedurën e ndërmjetësimit në gjykata e cila në nenin 4 të saj përcakton se “*Edhe gjyqtari ne seancën përgatitore ose ne shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kane mundësi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit*”.

Ky obligim i gjyqtarit të rastit, në rastin konkret nuk është zbatuar.

Duke vepruar në këtë mënyrë, përkatësisht duke mos referuar rastin në procedurë të ndërmjetësimit, gjykata ka dëmtuar interesat e palës së dëmtuar, pasi ka prolonguar realizimin e kërkesës pasurore juridike, të cilën tanimë pala e dëmtuar duhet ta bëjë përmes procedurës civile.

Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit përpos që ka ngarkuar vetën me një lëndë që potencialisht ka pasur mundësi të zgjidhet në procedurë të ndërmjetësimit, i njëjti mund të ngarkojë me një lëndë të re edhe divizionin civil, ku pala e dëmtuar obligohet të iniciojë procedurë për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Po ashtu, përpos palës së dëmtuar dhe vetë gjykatës, në rastin konkret janë dëmtuar interesat ligjore edhe të të pandehurit, rasti i të cilit ka qenë i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Rasti Nr.2

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.3727/16

Vepra penale: “Asgjësimit apo dëmtim të pasurisë”

Gjykatësi: Kushtrim Shyti

Prokuror: Fikrije Sylejmani

I pandehur: Avni Krasniqi

Faza e procedurës : Aktgjykim i plotfuqishëm

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 8 shtator 2016, ka ngritur aktakuzë ndaj Avni Krasniqi për shkak të veprës penale “Asgjësimit apo dëmtimi i pasurisë”, nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Sipas prokurorisë, më 31 korrik 2016, rreth orës 11:35, në rrugën “Luboteni” në Prishtinë, me qëllim ka dëmtuar pasurinë e

luajtshme të personit tjetër, të dëmtuarit Fatmir Krasniqi, në atë mënyrë që fillimisht i akuzuari dhe i dëmtuari ishin fjalosur mes vete, e pastaj i akuzuari me anë të një guri e ka goditur veturën e të dëmtuarit, të tipit “Land Rover”, dhe të njëjtën e ka dëmtuar në xhamin e përparmë si dhe derën e anës së majtë, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Prishtinë më 1 korrik 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Krasniqi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej katër muaj burgim efektiv, kjo pasi që Krasniqi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Krasniqi dhe të dëmtuarin Fatmir Krasniqi, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Sikurse edhe në rastin paraprak, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.3

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.2670/16

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve komunale”

Gjykatësi: Hanefi Jashari

Prokuror: Nebahate Salihu

I pandehur: Gaster Rexhepi

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së ngritur më 15 qershor 2016, Gaster Rexhepi akuzohet se prej kohës së pavërtetuar e deri më 22 dhjetor 2015, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, është hasur në shtëpinë e tij duke e shfrytëzuar energjinë elektrike, në mënyrë të paautorizuar, në atë mënyrë që për tu furnizuar me energji elektrike, i akuzuari ka bërë kyçje në rrjetin elektrik pa njehsor elektrik dhe si pasojë është pamundësuar regjistrimi i energjisë elektrike, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 284,46 euro.

Me këto veprime, prokuroria e ngarkon të akuzuarin Gaster Rexhepi se ka kryer veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Prishtinë më 3 prill 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Rexhepi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve burgim me kusht, dhe dënim me gjobë në lartësi prej 100 euro, kjo pasi që Rexhepi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në

procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Rexhepi, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.4

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.4444/17

Vepra penale: “Lëndim i lehtë trupor”

Gjykatësi: Avni Syla

Prokuror: Menduhi Kastrati

I pandehur: Lorik Gjokolli

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 2 tetor 2017, ka ngritur aktakuzë ndaj Lorik Gjokolli në drejtim të kryerjes së veprës penale “Lëndim i lehtë trupor”, nga neni 188 par.1, nën par. 1,4 të KPRK-së.

Sipas prokurorisë, më 13 dhjetor 2016, rreth orës 13:30, në rrugën “Hasan Prishtina”, Obiliq, konkretisht në barnatoren “Shëndeti”, pas një mosmarrëveshjeje të atëçastshme, që i akuzuari Lorik Gjokolli kishte pasur me të dëmtuarin Besart Misini, me dashje që t’i shkaktojë lëndime trupore e kishte sulmuar fizikisht, duke e goditur me grushte në fytyrë.

Gjithnjë sipas akuzës, pas goditjeve të dëmtuarit i janë shkaktuar lëndime të lehta

trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Prishtinë më 11 qershor 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Gjilkolli, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 150 euro, kjo pasi që Gjilkolli në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Gjilkolli dhe të dëmtuarin Besart Misini, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.5

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: P.nr.5036/16

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve komunale”

Gjykatësi: Adnan Isufi

Prokuror: Merita Shala-Muhaxhiri

I pandehur: Fehmi Krasniqi

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 1 dhjetor 2016, ka ngritur aktakuzë ndaj Fehmi Krasniqit për shkak të veprës penale

“vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 të KPRK-së.

Sipas prokurorisë, me 30 nëntor 2015, në shtëpinë e tij në rrugën “Edmond Hoxha”, p.n. në Prishtinë, i akuzuari Fehmi Krasniqi, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, është kyçur në rrjetin elektrik jashtë njehsorit elektrik, duke mundësuar shpenzimin e energjisë elektrike pa matje, me ç’rast i ka shkaktuar dëm KEDS-it në vlerë prej 190.36 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Prishtinë më 15 korrik 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Krasniqi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 150 euro, kjo pasi që Krasniqi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Krasniqi, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.6

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: P.nr.872/18

Vepra penale: “Sulm”

Gjykatësja: Iliriana Hoti

Prokuror: Mone Syla

I pandehur: Fadil Bajramaj

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Fadil Bajramaj po akuzohet se më 13 nëntor 2018, rreth orës 14:05, në fshatin Kralan, me dashje përdor forcën ndaj të dëmtuarit Gazmend Cermjani.

Ngjarja kishte ndodhur në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke punuar në fshatin Kralan, duke i vendosur gypat e ujit të pijes, meqenëse i njëjti punon si bagerist në “KRU Gjakova”, i akuzuari i është afruar duke i thënë se deri në cilin vend jeni duke i vendosur gypat e ujit, edhe përkundër faktit se i dëmtuari ia shpjegon se deri ku e ka të caktuar për të dërguar gypat e ujit, i akuzuari fillon duke i thënë se lagjes tjetër ia kanë dërguar deri në oborr, i dëmtuari prapë i drejtohet duke i thënë se për këtë vendos drejtori, më pas i akuzuari tenton që ta largojë nga aty, e sulmon duke e goditur me shqelm në bark dhe për një moment ndërhyjnë punëtorët të cilët i kanë ndarë, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit dhimbje.

Për këtë, Bajramaj ishte akuzuar se kishte kryer veprën penale “sulmi”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Gjakovë më 5 qershor 2019 e kishte shpallur fajtor të akuzuarin Bajramaj, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim me tre

muaj burgim me kusht, kjo pasi që Bajramaj në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësja e çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Bajramaj dhe të dëmtuarin Gazmend Cermjani, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.7

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: P.nr.889/18

Vepra penale: “Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”

Gjykatësja: Iliriana Hoti

Prokuror: Deshirë Jusaj

I pandehur: Faton Quni

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, e ngritur më 18 dhjetor 2018, Faton Quni po akuzohet se më 3 nëntor 2018, rreth orës 10:00, në lagjen Brekoc të Komunës së Gjakovës, seriozisht e kanos zyrtarin policor Flamur Frrokaj.

Ngjarja ka ndodhur në atë mënyrë që pasi fillimisht i akuzuari ishte ndaluar në fshatin Korenicë të Komunës së Gjakovës, për shkak të tejkalimit të shpejtësisë në zonën 40 km/h, dhe pasi të njëjtit i shqiptohet

gjoba kundërvajtëse, i revoltuar ofendon policët duke iu thënë “Jeni njerëz të pashkollë dhe se nuk dini të kryeni detyrën e juaj dhe do të shihemi”, dhe pasi vullshëm ka lëvizur nga aty, ndalohe në lagjen Brekoc nga Policia e njëjtë, ku refuzon t’i prezanton dokumentet dhe kanos policin Flamur Frrokaj me fjalët se “Do të shihemi privatisht”, për çka, arrestohet dhe dërgohet në Stacion Policor.

Për këtë, sipas aktakuzës, ai akuzohet se ka kryer veprën penale “sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare” nga neni 410 parag.1 të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Gjakovë më 6 qershor 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Quni, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim me tre muaj burgim me kusht, kjo pasi që Quni në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësja e çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Quni dhe të dëmtuarin Flamur Frrokaj, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.8

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: Pnr.721/2018

Vepra penale: “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”

Gjykatësi: Gëzim Ademi

Prokuror: Sahit Tmava

I pandehur: Dushan Milliq

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, më 10 shtator 2018, ka ngritur aktakuzë ndaj Dushan Milliq për shkak të veprës penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Sipas prokurorisë, më 3 qershor 2017, rreth orës 00:10, në rrugën “Krala Petra” në Mitrovicë, në bastoren “Millenium 8”, ka asgjësuar dhe dëmtuar pasurinë e personit tjetër, të dëmtuarit Ivan Markiq pronar i bastores ia then 6 televizora dhe pajisje të tjera në vlerë prej 4,000 euro, pasi kishte hyrë në gjendje të dehur në bastore.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Mitrovicë e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Milliq, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim në kohëzgjatje prej tre muaj burgim kusht, kjo pasi që Milliq në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Milliq dhe të dëmtuarin Ivan Markiq, edhe pse rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga

KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.9

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë

Numri i lëndës: Pnr.175/18

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve”

Gjykatësi: Lulzim Paçarizi

Prokuror: Bajram Kryeziu

I pandehur: Mehmet Krasniqi

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ngritur më 25 prill 2018, Mehmet Krasniqi, akuzohet se më 25 shtator 2017, në shtëpinë e tij, në fshatin Lladrovc, Komuna e Malishevës, në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike, duke anashkaluar njehsorin elektrik e kyç një pjesë të shtëpisë pa matje, e që me këto veprime e ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike.

Sipas aktakuzës, i akuzuari të dëmtuarës KEDS – Distrikti Prishtinë, i ka shkaktuar dëmin në vlerë prej 158 euro.

Me këtë, ai akuzohet se ka kryer veprën penale “vjedhje e shërbimeve”, nga neni 314, paragraf 6, lidhur me paragrafin 1, të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Gjakovë, dega në Malishevë më 22 gusht 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Krasniqi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim tre muaj burgim me kusht, kjo pasi që Krasniqi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Krasniqi, edhe përkundër faktit se rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.10

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë

Numri i lëndës: Pnr.272/17

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve”

Gjykatësi: Njazi Morina

Prokuror: Ismet Tofaj

I pandehur: Ruzhdi Begaj

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë të ngritur më 28 gusht 2017, Ruzhdi Begaj, akuzohet se nga data e pavërtetuar e deri më 12 gusht 2015, në shtëpinë e tij, në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, më qëllim që vetit t'i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, duke manipuluar me njehsorin elektrik, ka thyer xhamin e njehsorit elektrik, dhe ka penguar

rrotullimin e diskut, me këtë e ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike.

Sipas dispozitivit të parë të aktakuzës, kjo gjendje është konstatuar nga Qendra e Kalibrimit të Divizionit të Rrjetit në Prishtinë.

Sipas dispozitivit të dytë të aktakuzës, po ashtu nga data e pavërtetuar e deri më 29 shtator 2016, në shtëpinë e tij, në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës, më qëllim që vetit t'i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, duke u lidhur direkt përmes kabllos në rrjetin elektrik, ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike.

Ndërsa, sipas dispozitivit të dytë, i akuzuari të dëmtuarës KEDS-Distrikti Gjakovë, i ka shkaktuar dëmin në vlerë prej 176.37 euro.

Me këtë, Ruzhdi Begaj akuzohet se ka kryer veprën penale, “vjedhje e shërbimeve komunale”, në vazhdimësi nga neni 320, paragrafi 1, në kuptim të nenit 81, të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Gjakovë, dega në Malishevë më 1 shkurt 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Begaj, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim tre muaj burgim dhe 200 euro gjobë me kusht, kjo pasi që Begaj në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Begaj, edhe për kundër faktit se rasti ishte i përshtatshëm për ndërmjetësim.

Edhe në këtë rast, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.

Rasti Nr.11

Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë

Numri i lëndës: P.nr.455/17

Vepra penale: “Vjedhje e shërbimeve”

Gjykatësi: Njazi Morina

Prokuror: Mone Sylja

I pandehur: Flurim Paçarizi

Faza e procedurës: Aktgjykim i plotfuqishëm

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të ngritur më 29 dhjetor 2017, Flurim Paçarizi akuzohet se nga data e pavërtetuar e deri më 5 maj 2017, në shtëpinë e tij në fshatin Lubizhd, Komuna e Malishevës, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, duke u lidhur direkt në rrjetin elektrik përmes kabllos dhe me këto veprime e ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike.

Sipas aktakuzës, i akuzuari të dëmtuarës KEDS–Distrikti Gjakovë i ka shkaktuar dëmin në vlerë prej 91 euro.

Me këtë i akuzuari ka kryer veprën penale “vjedhje e shërbimeve”, nga neni 314, paragraf 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit:

GjTh në Gjakovë, dega në Malishevë më 1 gusht 2019 e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Paçarizi, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënim 90 ditë burgim me kusht, kjo pasi që Paçarizi në shqyrtim fillestar e kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

IKD gjatë monitorimit ka gjetur se gjykatësi i çështjes, nuk e kishte referuar në procedurë të ndërmjetësimit të akuzuarin Paçarizi, edhe për kundër faktit se lënda ka qenë e përshtatshme për ndërmjetësim.

Sikurse edhe në rastet paraprake, duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtari i rastit ka shkelur rregulloren e miratuar nga KGJK, ka dëmtuar interesin e palës së dëmtuar, interesin e të pandehurit si dhe ka ngarkuar sistemin gjyqësor dhe vetën e tij me lëndë të cilat potencialisht kanë pasur mundësi të zgjidhen në procedurë të ndërmjetësimit.